



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
KORÇË

Nr.Regj. 61000-01630-41-2024 (267 Regj)  
Datë regjistrimi 12.08.2024

Nr.Vendimi 41-2024-2848 (267 Regj)  
Datë vendimi 13.08.2024

V E N D I M

VLEFTËSIM ARRESTI NË FLAGRANCË  
CAKTIM MASE SIGURIMI

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë prej:

**Gjyqtare Luljeta KOLE**

Asistuar nga sekretare Elida Hymeti, në Korçë, në datë 13.08.2024 ora 11.30, shqyrtoi në seancë gjyqësore publike çështjen penale që ju përket :

**PROKURORISË** pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, përfaqësuar nga prokurore Vasjana Postol.

**Shtetas nën hetim:** 1.**Denis Meçe**, i biri i Dritan dhe Valentina, dtl.03.06.1995, lindur dhe banues në Buçimas, Pogradec, me shtetësi shqiptare, gjendja familjare i martuar, arsimi i lartë, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, mbrojtur nga avokat Eduart Muçi, i zgjedhur nga vetë shtetasi nën hetim me deklaram në seancë gjyqësore.

**I dyshuar:** për veprën penale “Vrasja nga pakujdesia“ parashikuar nga neni 85 i K.Penal.

2.**Voltan Shkulaku**, i biri i Saliko dhe Fatbardha, dtl.10.01.1984, lindur në Stropckë, Pogradec dhe banues në Pogradec, me shtetësi shqiptare, gjendja familjare i martuar, arsimi i lartë, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, mbrojtur nga avokat Budion Hoxha, i zgjedhur me prokurë nga familjarët dhe nga vetë shtetasi nën hetim me deklaram në seancë gjyqësore.

**I dyshuar:** për veprën penale “Moskallzimi i krimit“ parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

3.**Arian Manellari**, i biri i Çelnik dhe Shegë, dtl.17.11.1969, lindur dhe banues në Gështenjas, Pogradec, me shtetësi shqiptare, gjendja familjare i martuar, arsimi 8 klasë, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, mbrojtur nga avokat Esmerald Xhafa, i zgjedhur nga vetë shtetasi nën hetim me deklaram në seancë gjyqësore.

**I dyshuar:** për veprën penale “Moskallzimi i krimit“ parashikuar nga neni 300 i K.Penal.



4. **Leonidha Guçe**, i biri i Xhemil dhe Shqipërie, dtl. 17.10.1977, lindur në Bishnicë, Pogradec dhe banues në Mëmëlisht, Pogradec, me shtetësi shqiptare, gjendja familjare i martuar, arsimi 9 klasë, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, mbrojtur nga avokat Esmerald Xhafa, i zgjedhur nga vetë shtetasi nën hetim me deklaram në seancë gjyqësore.  
**I dyshuar**: për veprën penale "Moskallzimi i krimi" parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

**OBJEKTI:** Vleftësim arresti në flagrancë, Caktim mase sigurimi,

**Baza ligjore:** Neni 244 dhe 258 i K.Pr.Penale.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës penale, në diskutimin përfundimtar palët kërkuar:

Prokurore Vasjana Postol: -Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit dhe caktimin ndaj shtetasit Denis Meçe të masës së sigurimit "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

-Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit dhe caktimin ndaj shtetasit Voltan Shkulaku të masës së sigurimit "detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

-Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit dhe caktimin ndaj shtetasit Arian Manellari të masës së sigurimit "detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

-Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit dhe caktimin ndaj shtetasit Leonidha Guçe të masës së sigurimit "detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

Av. Eduart Muci, në cilësinë e mbrojtësit të zgjedhur nga shtetasi Denis Meçe, kërkoj që të cilësohet si i ligjshëm arrestimi në flagrancë për këtë shtetas, dhe të caktohet ndaj tij një masë sigurimi më e lehtë se ajo që ka kërkuar prokuroria, sikurse "arrest në shtëpi" apo edhe "garancia pasurore" në vlerën 1.000.000 lekë.

Shtetasi nën hetim Denis Meçe u shpreh dakord me mbrojtësin.

Av. Budion Hoxha në cilësinë e mbrojtësit të zgjedhur nga shtetasi Voltan Shkulaku, kërkoj që të cilësohet si i paligjshëm arrestimi në flagrancë për këtë shtetas, dhe të mos caktohet ndaj tij asnjë masë.

Shtetasi nën hetim Voltan Shkulaku u shpreh dakord me mbrojtësin.

Av. Esmerald Xhafa në cilësinë e mbrojtësit të zgjedhur nga shtetasi Arian Manellari, kërkoj që të cilësohet si i ligjshëm arrestimi në flagrancë për këtë shtetas, dhe të caktohet ndaj tij masa e sigurimit "detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore" sipas kërimit të prokurorisë.

Shtetasi nën hetim Arian Manellari u shpreh dakord me mbrojtësin.

Av. Esmerald Xhafa në cilësinë e mbrojtësit të zgjedhur nga shtetasi Leonidha Guçe, kërkoj që të cilësohet si i ligjshëm arrestimi në flagrancë për këtë shtetas, dhe të caktohet ndaj tij masa e sigurimit "detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore" sipas kërimit të prokurorisë.

Shtetasi nën hetim Leonidha Guçe u shpreh dakord me mbrojtësin.



Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën, dëgjoi palët dhe pasi vlerësoi provat e paraqitura,

### V Ë R E N

Në datë 12.08.2024 ora 15.30 nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesa për vleftësimin e arrestit në flagrante dhe caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" ndaj shtetasit Denis Meçe, i dyshuar për veprën penale "Vrasja nga pakujdesia", parashikuar nga neni 85 i K.Penal, si dhe vleftësimin e arrestit në flagrante dhe caktimin e masës së sigurimit "Detyrimi për paraqitje në policinë gjyqësore" ndaj shtetasve Voltan Shkulaku, Arian Manellari dhe Leonidha Guçe, të dyshuar për veprën penale "Moskallzimi i krimi", parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Në bazë të neneve 278 dhe 244/1 të K.Pr.Penale, shqyrtimi i kësaj kërkesë në fazën e hetimeve paraprake hyn në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate. Kjo për faktin se është gjykata e vendit ku mendohet të jenë kryer veprimet që i atribuohen të dyshuarve si vepër penale.

Nga faktet dhe provat e paraqitura në seancë gjyqësore, rezultoi se në datë 10.08.2024 rreth orës 19:00, është marrë njoftim se në afërsi të vendit të quajtur "Agjensia", tek rrethrotullimi, lagjia nr.2 në Pogradec, përballë me bar-kaf "Stropcka", është gjetur një shtetas i shtrirë pa ndjenja. Pas mbërritjes së punonjësve të policisë locale, është identifikuar shtetasi i dëmtuar si Eglantin Proga, i biri i Nazmi dhe Ismete, i datëlindjes 06.05.1982, lindur dhe banues në Trebinjë, Pogradec. Ai është transportuar për në Spitalin e qytetit të Pogradecit, por pa shenja jete.

Është këqyrur vendi i ngjarjes, territori rrugë, trotuar dhe ambjent bar-kafe pronë e shtetasit Voltan Shkulaku, ku evidentohet në procesverbalin përkatës se nuk janë vënë re çrregullime në ambjent.

Në cilësinë e provës materiale është marrë një kartpicetë e bardhë, me njolla me ngjyrë, si ajo e gjakut, e gjetur përballë lokalit, në distancë 1.9 metra nga buza e trotuarit, në asfalt. Në brendësi të lokalit, mbi një prej tavolinave të shërbimit, janë gjetur dhe marrë në cilësinë e provës materiale, një çantë e vogël material imitim lëkure ngjyrë e zezë, me mbishkrimin "Polo", e cila në brendësi ka një dokumet bankar, një portofol me ngjyrë kafe që në brendësi mban duhan të grirë, një kuti filtrash cigare ngjyrë e zezë me mbishkrim "Ocb", një pako letër cigaresh për cigare të dredhur dhe një aparat telefon celular i markës "Samsung" në pjesën e pasme me ngjyrë gri dhe pjesa e ekranit me plasaritje të shumta, ky aparat u paraqit i ndezur, por që kërkohet kodin e hapjes. (këto sende i përkasin shtetasit Eglantin Proga).

Nga këqyrja e kufomës së personit të identifikuar si Eglantin Proga, rezulton me veshje normale të stinës (veshje të pa dëmtuara). Nga kontrolli i tyre u gjetën në xhepin e djathtë përpara të pantallonave 8700 lekë dhe 5 euro (prerje të ndryshme), në xhepin e pasëm djathtas u gjet një portofol ngjyrë kafe në brendësi të tij 1 kartë banke Raiffeisen Bank, 1 kartë banke Tirana Bank, 1 lehtë drejtimi me emrin Eglantin Proga, 2 karta antarësimi të Partisë Socialiste me emrat Ersila Proga dhe Eglantin Proga, 1 letër e vjetër me shënime (shifra). Në xhepin e pasëm majtas 2 kartmonedha 2000 lekshë. Koka e mbuluar me flokë ngjyrë gështenjë të prera shkurt në prekje pa dëmtime të kockave. Në pjesën e ballit të anës së majtë vihet re hematome, ekimozë me madhësi 5x3 cm. Hunda në pjesën e kurrizit ka një hematome 2 cm pa sekrecione. Në pjesën e faqes së majtë vihet re dërmishje pothuajse në të



gjithë sipërfaqen e saj, po ashtu gjak i mpiksuar që fillon nga pjesa e syrit të majtë deri në veshi i majtë. Veshi i majtë me mbetje njolla si ato të gjakut të mpiksuar. Goja e mbyllur, gjuha në zgavrën e saj, dhëmbët të pranishëm poshtë dhe lart me mbetje si ajo e gjakut të mpiksuar në sipërfaqen e tyre. Gjithashtu, vihet re lacerim i buzës së poshtme në anën e majtë nga brenda me diametër 1 cm. Dërmishje në buzën e sipërme, në pjesën e mjekrës dhe faqes së djathtë. Llapa e veshit të majtë me hematomë me praninë edhe të dërmishjeve. Tek supi i majtë vihet re një dërmishje me përmasa 2.5x1cm. Në pjesën e parakrahut të majtë afër dorës vihet re një dërmishje me përmasa 2x2cm. Në pjesën e majtë dhe të djathtë të trupit vihen re shenjat e elektrodave të procesit të kardioreanimimit (elektroshok nga stafi mjekësor). Tek gjuri i majtë vihet re ekimozë me përmasa 4x1cm. Në testet e kufomës vihet re lëndim.

Lidhur me ngjarjen është pyetur shtetasi Voltan Shkulaku, pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja, i cili ka deklaruar: "Unë kam me qera një ambient të përshtatur lokal bar-kafe, që ndodhet në lagjen nr.1 Pogradec, pikërisht tek agjensia, përbri hyrjes së ish terminalit. Ditën e sotme kam qenë në lokal që nga mëngjesi, pasi punoj vetë aty dhe deri në orën 19.00, kur kam qenë duke pastruar lokalin. Në lidhje me shtetasin Igli i Nazmiut, por mbiemrin nuk ja di, deklaroj se ai ka hyrë në lokalin tim rreth 10 minuta përpara ngjarjes. Sapo ka hyrë në lokal ka porositur një birrë të llojit "Elbar" dhe është ulur në tavolinën time dhe të shokut tim Andi Shkulaku, pasi ne ishim bashkërisht në tavolinë. Në atë moment i kam dhënë birrën dhe pas kësaj jam ngritur dhe po pastroja në banak. Shpjegoj se Igli, mesa pashë kur erdhi në tavolinë, kishte konsumuar alkool tek lokali i tij, pasi ka një lokal bar-kafe afër lokalit tim, rreth 50 metra më tutje dhe ka ardhur aty. Në kohën që unë jam ngritur për të pastruar, ai është ngritur dhe ka shkuar në tualetin e lokalit. Nuk jam shumë i sigurt, nëse sapo ka dalë nga tualeti është ulur në tavolinë apo ka dalë direkt përjashta, por pak më vonë kam dëgjuar disa persona që kanë folur me zë të lartë dhe kërkonin ujë. Unë jam hutuar në atë moment dhe kur kam dalë jashtë nuk kam nxjerrë as ujë, por një nga rruga ka sjellë një bidon. Kam parë se shtetasi Igli ishte i shtrirë në tokë dhe aty ishin mbledhur shumë persona të tjerë dhe e kam ngritur duke e kapur nga trupi, por ai nuk reagoi, megjithëse unë i kam nxjerrë gjuhën jashtë dhe ai në atë moment nxirrte vetëm shkumë nga goja. Aty ka ardhur ambulanca që e ka marrë dhe e ka çuar në spital, ndërsa unë kam vazhduar tek lokali. Kur kam hyrë në tualet kam vënë re se ai kishte nxjerrë aty, pasi kishte të vjella. Kam bërë pastrimin e tualetit dhe të lokalit dhe kam bërë mbylljen e lokalit dhe isha akoma tek lokali kur ka ardhur policia".

I pyetur nëse viktimën kishte shkuar vetëm apo i shoqëruar në lokal, ai është përgjigjur: "Ai ka qenë vetëm fare kur ka ardhur tek lokali im dhe sapo ardhë është ulur në tavolinën ku isha unë së bashku me Andi Shkulakun, ka porositur birrë për vete dhe një birrë për Andin, ndërsa unë në atë moment jam ngritur nga tavolina për të bërë pastrimet".

I pyetur nëse e ka dëgjuar viktimën të debatonte me dikë ai është përgjigjur: "Jo nuk kanë bërë asnjë lloj debati apo konflikti midis tyre dhe ka ndejtur shumë pak kohë, pasi vetëm gjysmën e birrës ka pirë dhe është ngritur ka shkuar në tualet. Siç thashë, nuk e kam fiksuar nëse ai kur ka dalë nga tualeti u ul prapë në tavolinë apo ka dalë jashtë, por vetëm kur kanë thirrur me zë të lartë që kërkonin ujë dhe kam dalë me të shpejtë jashtë dhe e pashë atë të shtrirë në tokë, e ngrita për t'i dhënë ndihmë derisa erdhi ambulanca që e mori".

I pyetur se cilët persona kanë qenë të pranishëm, ai shpjegon: "Brenda në lokal kam qenë vetëm unë dhe Andi Shkulaku të ulur në të njëjtën tavolinë ku është ulur dhe Igli, por në momentin që ai është ulur dhe ka porositur dy birra për vete dhe për Andin, unë jam ngritur që shërbeva birrat dhe pas kësaj nuk jam ulur më me ta, pasi kam filluar të bëj pastrimet në lokal. Po kështu shpjegoj se, tek tavolinat jashtë kanë qenë shtetasit Leonidha Guçe, Arian nga fshati Gështenjas që unë di se jeton në Austri apo në Zvicër dhe ka ardhur për pushime, si dhe një person i tretë të cilin nuk e njoh fare, por që kanë qenë të tre në tavolinë së bashku të ulur përjashta. Të tjerë persona nuk kam patur aty në lokal".



I pyetur nëse kishte dëgjuar që viktima të kishte konflikt apo të ishte konfliktuar me ndonjë person, ai është përgjigjur: "Jo nuk është zënë me njeri aty dhe aq pak sa ndejta unë me të kam dëgjuar se ishte i mërzitur dhe më ka thënë se do ta mbyllte lokalit. Nuk kam folur me asnjë nga personat aty, pasi më ka zënë gjaku, se ai ishte me gjak në fytyrë dhe unë e kam fshirë me kartpeceta dhe nuk kam komunikuar me asnjë derisa ardhni policia që na ka shoqëruar në Komisarjatin e Policisë Pogradec. Shpjegoj se kamera që kam unë tek lokali e kam kontrolluar dhe nuk regjistronte fare, por vetëm sa sheh në moment dhe asgjë më tepër".

Lidhur me ngjarjen është pyetur shtetasi Ardian Bego, i cili ka shpjeguar: "Ditën e sotme rreth orës 18.30 unë kam dalë nga banesa ime dhe kam shkuar në një dyqan me vegla ndërtimi, i cili ndodhet përballë pallatit ku unë jetoj. Në këtë dyqan unë kam qenë duke bërë muhabet me të zotin e këtij dyqani, i cili quhet Guri. Rreth orës 18.45, mesa mbaj mend, në një distancë rreth 30 metra në drejtim të një lokali, i cili është në pronësi të shtetasit i cili quhet Voli, por mbiemrin nuk ja di dhe konkretisht përballë këtij lokali, kam parë një person i cili u godit nga një person tjetër me grusht në pjesa e kokës dhe ra në tokë në pjesa e asfaltit. Une nuk jam afruar, por kam parë nga larg që nga lokali ka dalë i zoti i lokalit shtetasi me emrin Voli, ku i është afruar personit të rrëzuar në tokë dhe po i jepte ndihmë. Personi me të cilin unë po qëndroja në dyqanin e veglave të ndërtimit më tha se personi që ishte rrëzuar në tokë ishte kushëriri im shtetasi Eglantin Proga. Unë në këtë kohë, sapo mora vesh për kushëririn tim, menjëherë jam afruar në vendi ku ai ishte rrëzuar dhe pashë atje që ai ishte pa ndjenja dhe nuk reagoonte fare. Në këtë kohë ka ardhur dhe shërbimi i policisë dhe persona që ishin atje pranë lajmëruan dhe ambulancën. Kam kërkuar ndihmë rreth e rrotull për ndonjë person që mund ta merrte në makinë kushëririn tim dhe ta çonim në spital për ndihmë mjeksore, por pas 10 minutash ka ardhur ambulanca dhe e transportoi në spitalin e Pogradecit, ku në ambulancë kam hipur dhe unë. Përsëri dhe në ambulancë, kushëriri im, shtetasi Eglantin Proga, nuk po reagoonte fare. Në ambientet e spitalit mjeku kardiolog më komunikoi se, pas ndihmës së dhënë me elektroskok, ai përsëri nuk kishte reaguar dhe me konfirmoi që kushëriri im kishte ndërruar jetë. Kam lajmëruar familjarët e tij dhe kam qëndruar në spital. Theksoj se kushëriri im ka një lokal i cili ndodhet rreth 30 metra larg vendit ku ndodhi ngjarja për në drejtim të rrugës së tregut".

I pyetur nëse mund ta identifikonte personin që kishte gjuajtur shtetasin Eglantin Proga, ai ka deklaruar: "Unë nuk munda dot të identifikoj personin që goditi me grusht kushëririn tim, shtetasin Eglantin Proga, përballë lokalit të shtetasit me emrin Voli, për arsye se në fillim kur unë pashë që ai u godit, nuk isha i interesuar për këtë konflikt se isha shumë larg dhe nuk e dija për kë bëhej fjalë, se po ta dija do kisha shkuar menjëherë që në fillim dhe nuk kam dëgjuar kur e pashë as të bërtitura dhe as të shara".

I pyetur se çfarë karakteristika kishte personi që goditi me grusht Eglantin Progën, ai ka deklaruar: "Unë nuk kam mundur dot të fiksoj personin që goditi me grusht kushëririn tim, shtetasin Eglantin Proga, përballë lokalit të shtetasit me emrin Voli dhe nuk e kam vënë re se në çfarë drejtimi u largua ai pasi atje u mbledhën shumë njerëz".

I pyetur nëse mund të identifikonte ndonjë nga personat e tjerë të pranishëm, ai është shprehur: "Në kohën kur ndodhi ngjarja mesa pashë në lokali i personit me emrin Voli, në tavolinat e jashtme të këtij lokali, në kohën kur ndodhi ngjarja ishte i pranishëm dhe shtetasi me emrin Klodi, por mbiemrin nuk ja di dhe ky person mund ta ketë parë konfliktin që në fillim. Këtij shtetasi unë i kam kërkuar ndihmë që ai me makinën e tij të na çonte në spital, por ai nuk pranoi".

I pyetur nëse shtetasi Eglantin Proga ka patur ndonjë konflikt dhe nëse po, me kë, ai ka deklaruar: "Unë nuk e di nëse ka pasur konflikte apo jo kushëriri im shtetasi Eglantin Proga".

I pyetur kush tjetër ka qenë present, ai është përgjigjur: "Në momentin që unë kam konstatuar të shtrirë në tokë kushëririn tim shtetasin Eglantin Proga, ka qenë personi me emrin Voli i cili



po mundohej ta ndihmonte. Atje pranë ka pasur dhe persona të tjerë rreth e rrotull por nuk i mbaj mend dhe nuk i njoh për shkak se u shqetësova shumë".

Në lidhje me ngjarjen është pyetur shtetasi Andi Shkulaku, i cili midis të tjerash ka deklaruar se: "Ka qenë i ulur për të pirë kafe tek bar kafe "Stropeka" në Pogradec. ai ka qenë i ulur në një tavolinë brenda lokalit i vetëm, atje herë pas here ulëj edhe pronari i lokalit shtetasi Volant Shkulaku, brenda nuk ka patur njerëz të tjerë, por kur ka hyrë ka parë në tavolina jashtë ishte ulur shtetasi Denis Meçe, Klodi Guçe dhe një person tjetër me emrin Arian. Ai tregon se pas rreth një ore, atje ka shkuar shtetasi Eglantini Proga dhe është ulur në tavolinën e tij Brenda. Ai nuk kishte shumë njohje me të por ngaqë në tavolinë ka qenë edhe pronari i lokalit, Eglantini është ulur atje. Eglantini ka porositur birra për të dhe për vete, edhe pse sipas tij ishte i dehur dhe vinte era alkool. Pasi kanë konsumuar birrat, në tavolinë ju ka shkuar dhe një porosi tjetër me birra nga një shtetas i cili ishte ulur jashtë, më pas ai mësoi se ishte nga shtetasi Klodi Guçe. Gjatë kohës që ata kanë qenë në lokal, Eglantini është ngritur disa herë dhe ka shkuar në tualet. Pasi ka dalë nga tualeti ka filluar të dredhë një cigare. Denis Meçe i cili ishte ulur në një tavolinë jashtë lokalit në trotuar me dy persona të tjerë, i ka thënë Eglantinit 2-3 herë që t'i dridhte një cigare, Eglantini i ka thënë "ja se po ta dredh". Ai drodhi cigare për vete dhe më pas drodhi edhe për Denisin dhe pasi e bëri gati i tha "Denis hajde mere se ta drodha". Denis ka hyrë brenda, ka marrë cigaren dhe kanë filluar të dy me njëri-tjetrin duke thënë "o kushëri" njëri, "o kushëri" tjetri. Pas një çasti, Eglantini i thotë Denisit "o b.th q..rë, mos më bëni si të fortë se ju q.. kurvat". Më pas kaluan përsëri me të qeshur. Në këtë moment Denis i thotë Eglantinit hajde dalim pak jashtë. Të dy kanë dalë jashtë dhe ai (Andi) po i shihte nga dritarja. Për rreth 1 minutë ata kanë debatuar në trotuar dhe pas debatit Andi ka parë që në një moment Denis Meçe godet me grusht Eglantinin dhe këtij të fundit i ka zënë koka në një makinë të parkuar atje pranë dhe më pas është rrëzuar në tokë duke i zënë koka në asfalt. Pas këtij momenti Andi është çuar dhe ka shkuar për t'i dhënë ndihmë personit të shtrirë në tokë, atje ka shkuar edhe pronari i lokalit dhe kalimtarë të rastit, por Eglantini nuk reagoonte dhe ishte i gjakosur nga goja dhe hundët. Më pas ai (Andi) ka njoftuar policinë duke kërkuar edhe ndihmën e ambulancës, e cila ka mbërritur pas rreth 10 minutash".

I pyetur nëse ishte në dijeni të ndonjë konflikti më të hershëm midit Eglantini Progës dhe Denis Meçes, Andi Shkulaku ka deklaruar se "Nuk di që të kishin konflikt por njiheshin me njëri-tjetrin".

I pyetur nëse personat e tjerë të pranishëm në tavolina jashtë kanë reaguuar për të shmangur konfliktin apo të jenë afruar për të dhënë ndihmë, ai ka deklaruar: "Ata erdhën për t'i dhënë ndihmë".

I pyetur se si ka reaguuar Denis Meçe pas konfliktit, ai është përgjigjur se: "Pas konfliktit Denis dukej i çoroditur dhe ulëj sa në një tavolinë në tjetra. Kur u kthye pas dhënies së ndihmës, nuk e pa më Denisin në lokal pasi ishte larguar".

Në lidhje me ngjarjen është pyetur shtetasi Roland Bezatliu, i cili ka qenë në lokal "Stropeka" por sipas deklarimit ai është larguar nga lokali përpara se të ndodhte ngjarja.

Është pyetur shtetasi Leonidha Guçe, i cili midis të tjerash ka deklaruar se "Rreth orës 15:00 ka shkuar dhe është ulur i vetëm tek lokal "Stropeka" në Pogradec, ka porositur një birrë dhe pas rreth 20 minutash ka shkuar dhe është ulur me të një mikun e tij Arian nga fshati Gëshenjës, pas Arianit rreth 10 minuta me mbrapa ka shkuar dhe është ulur në tavolinë me ata Denis Meçe i cili është nga Starova. Të tre kanë pirë disa birra dhe kanë qëndruar gjatë. Rreth orës 18:45 atje ka shkuar profesor Llazi i cili ka sjellë makinën që i kishte marrë Leonidhës, e ka parkuar pranë tyre, i ka dhënë çelësat dhe është larguar. Ndërkohë Leonidha



ka shkuar është ulur sërish në tavolinë me Denisin dhe Arianin. Ai ka parë që Denis është çuar nga tavolina, por nuk e ka parë se ku ka shkuar, ka hyrë brenda në lokal apo është larguar. Ndërkohë që ai ka qënë i ulur në tavolinë vetëm me Arianin, ka dëgjuar një grua që ka bërë titur: "sillni ujë dhe lajmëroni ambulancën". Leonidha tregon se është çuar nga tavolina dhe pas makinës së tij ka parë pronarin e lokalit të quajtur Voltan, i ulur në gjunjë, dhe mbante në prehër Eglantinin, të cilit po i hidhte ujë në qafë. Ai ka parë që Eglantini ishte i zverdhur në fytyrë. Ai ka dëgjuar nga njerëzit se Eglantinin e kishte goditur Denis Meçe, është ndjerë i çuditur nga ky fakt dhe se para se të ndodhte kjo situatë Denis ishte me ata në tavolinë. Ai ka parë rreth e rrotull, por nuk e ka parë Denisin, atje ishte vetëm Ariani i cili qëndronte ulur në tavolinë. Më pas ka dëgjuar që i kanë thënë që ai ta merrte në makinë dhe ta çonte në spital, por ka dëgjuar që ishte njoftuar ambulanca dhe nuk e ka marrë".

I pyetur nëse ka parë se kush e kishte goditur shtetasin Eglantin Proga, ai është përgjigjur: "Unë nuk e kam parë se kush e ka goditur Eglin, pasi nuk kam qënë i vëmendshëm në atë moment, kam qënë dhe në gjendje të dehur, kam parë vetëm atë momentin kur bërë tiste ajo gruaja për të sjellë ujë dhe për të njoftuar ambulancën, si dhe kur jam çuar nga tavolina kam parë që pronari i lokalit po i hidhte ujë Eglit, i cili ishte i shtrirë mbas makinës time, e cila ishte e parkuar në rrugë para tavolinës ku isha ulur duke pirë".

I pyetur kush ka qënë i pranishëm brenda dhe jashtë lokalit kur ka ndodhur ngjarja, ai ka deklaruar se "Ka parë vetëm Eglin brenda, pronarin Volantin, që hynte e dilte, Arjanin e Gështenjasit dhe Denis Meçen".

I pyetur për distancën e mjetit të tij të parkuar nga tavolina e tyre, ai deklaroi: "Rreth 6-7 metër distancë nga tavolina e tyre".

I pyetur nëse kishte parë Denisin dhe Eglantinin të dilnin bashkë nga lokali apo t'i ketë parë bashkë pranë makinës së tij të parkuar, ai është përgjigjur: "Unë nuk kam parë që Denis Meçe të dalë bashkë me Elgin nga lokali i Volit, apo të qëndronin bashkë pranë makinës time e cila ishte e parkuar pranë vendit ku po qëndroja. Di që Denis është larguar nga tavolina ku po qëndronim bashkë në fragment të shkurtër kohe para se të ndodhte ngjarja".

Në lidhje me ngjarjen është pyetur shtetasi Arian Manellari, i cili midis të tjerash ka deklaruar: "Ditën e sotme kam ardhur në Pogradec rreth orës 11:00, kam qënë tek një lokal afer urës atje poshtë ku kam pirë disa birra. Më pas rreth orës 17:00-18:00 kam shkuar tek lokali i Volit tek kafe "Stropcka", atje kam parë shokun tim Leonidha Guçe dhe jam ulur tek lokali atje tek një tavolinë jashtë në trotuar, më pas atje ka ardhur dhe një shtetas tjetër që e quajnë Denis, ai ka ardhur dhe është ulur me ne, pasi ishte dhe shoku im dhe kishte muhabet me atë. Atje kemi konsumuar birra nga 3 a nga 4. Në një moment kam parë që erdhi policia atje ne ishim ulur, unë të paktën nuk u ngrita fare të shikoja se çfarë u bë. Më pas erdhi ambulanca dhe pashë që mori një person. Më pas unë kam ikur në shtëpi dhe vonë më ka ardhur një punonjës policie në shtëpi dhe më ka marrë".

I pyetur nëse e njihnte më parë Denis Meçen dhe çfarë marrëdhënie kishte me të, ai është përgjigjur: "Unë e njoh si fytyrë, por nuk kam patur marrëdhënie".

I pyetur se çfarë veprimesh ka kryer shtetasi Denis Meçe gjatë kohës që ka qënë në lokal me të dhe sa ka qënë ora kur ai ka qënë me ta në lokal, ai është përgjigjur: "Për orën nuk e mbaj mend fare sa ka qënë, por ai qëndroi me ne dhe me sa më kujtohet ai u ngrit dhe hyri brenda dy tre herë dhe në fund kur ndodhi ajo që erdhi policia nuk e pashë më".

I pyetur nëse kishte persona të tjerë në lokal jashtë apo dhe brenda, a takoi njeri tjetër shtetasi Denis Meçe, ai është përgjigjur: "Jashtë në lokal kishte njerëz të tjerë, edhe brenda po ashtu kishte njerëz të tjerë, por kush i pa dhe nuk i mbaj mend se kush ishin. Denisin nuk e pashë, por brenda takoi një djalë dhe një tjetër".



I pyetur nëse e kishte parë shtetasin Denis Meçe që të dilte nga brenda lokalit me ndonjë person apo me shtetasin Eglantin Proga, ai është përgjigjur: "Unë nuk kam parë gjë fare sepse isha ulur me kurriz".

I pyetur nëse e ka parë se kush e ka goditur shtetasin Eglantin Proga dhe si ka ndodhur ngjarja, ai ka deklaruar sërish: "Jo unë nuk kam parë asgjë".

I pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasi Arian Manellari në prani të mbrojtësit ligjor ka deklaruar se i përmbahet thënieve që ka dhënë si deklarues dhe shton se nga konsumi i alkoolit ka qenë i dehur duke mos mbajtur mend mirë veprimet që kanë ndodhur.

Edhe shtetasi Volant Shkulaku është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, në prani të mbrojtësit të tij, ku ka dhënë këtë deklaram: "Unë deklaroj se u përmbahem thënieve që kam dhënë kur jam pyetur si person që tregon rrethana të hetimit, por dua të shtoj se në një moment kur isha duke punuar në banaku i lokalit tim, dëgjova që personi i tretë që ishte ulur në tavolina jashtë lokalit me shtetasit Leonidha Guçe dhe Arjanin, i cili e ka thirrur Iglin, ku e kam dëgjuar t'i thëriste me fjalët "Ajde pak jashtë", vetëm kaq kam dëgjuar dhe kam vazhduar duke punuar në lokal pasi kisha punë. Më vonë në një moment dëgjova britma të cilat vinin nga jashtë lokalit dhe zëra që kërkonin ujë. Sapo dëgjova këto zhurma dola jashtë lokalit dhe pashë Iglin e shtrirë në tokë dhe jam munduar t'i jap ndihmën e parë pasi asnjë nga njerëzit atje nuk po e ndihmonte. Më pas ka ardhur policia dhe ambulanca, e cila mori Iglin dhe e transportoi në spital".

I pyetur nëse e njihje personin i cili ka thirrur shtetasin Eglantin Proga duke i thënë "Ajde pak jashtë", ai është përgjigjur: "Unë nuk e njoh me emër personin i cili ka thirrur shtetasin Eglantin Proga duke i thënë "Ajde pak jashtë" por e njoh vetëm si fytyrë".

I pyetur nëse ka parë që shtetasit Eglantin Proga dhe personi i tretë që deklaroi, a debatuan ata ndërmjet tyre në ambientet e lokalit dhe nëse po, çfarë kanë debatuar, ai është përgjigjur: "Unë kam dëgjuar që shtetasit Eglantin Proga dhe personi i tretë që deklarova më lart po komunikonin ndërmjet tyre por nuk e di çfarë komunikuan sepse isha i zënë me punë dhe kisha mendjen në banaku".

I pyetur për momentin kur i ka dhënë ndihmë shtetasit Eglantin Proga, ai ka deklaruar: "Në momentin kur unë po i jepja ndihmë shtetasit Eglantin Proga, siç deklarova më lart, kam qenë i shokuar dhe nuk e di kush ishte rreth e përqark pasi isha i përqëndruar tek Iglin".

Për sa më sipër, gjatë kësaj kohe shtetasi Denis Meçe është kërkuar në rrugë, vende, e ambiente të cilat mund t'i frekuentonte, gjithashtu është telefonuar edhe në numrin e celularit 0693607544 i cili ka rezultuar i fikur, por nuk është bërë e mundur gjetja e tij. Vetëm në orën 03:30 ai është paraqitur në ambientet e Komisarariatit të Policisë Pogradec.

Është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Denis Meçe, në prani të avokatit të zgjedhur prej tij, ku ka deklaruar: "Unë deklaroj se ditën e sotme rreth orës 15:30, nuk e mbaj mend mirë orën, kam qenë në Pogradec dhe kam folur në telefon me shtetasin Klodi Guçe për tu takuar dhe ai më ka thënë hajde tek lokali "Stropcka" në agjensia, sa u ula po pi një birra. Unë kam shkuar atje dhe ai ishte ulur tek një tavolinë jashtë, ishte me një burrë të moshuar (kushëri i tij) por ai iku pas rreth 20-30 min. Më pas atje në tavolinë ka ardhur edhe një burrë i shëndoshë, edhe ai taksixhi, Arjani nga Zërvaska, por mbiemrin nuk ja di. Atje kemi biseduar për marrëdhënie pune, për pasagjerë nga shteti gjerman dhe po pinim birra. Gjatë kohës që ishim ulur atje, pas rreth 3 orësh (ora nuk më kujtohet) vjen ky djali, emrin nuk ja dija, por e njihja si fytyrë (Eglantin Proga), ai na ka përshëndetur dhe ka hyrë në lokal, në një moment mua më kanë mbaruar cigaret dhe kam hyrë brenda i kam thënë pronarit të lokalit, Volit, për cigare, por atje ky djali më ka thënë "ja se ta dredh një unë" dhe



unë për respekt ja mora. Unë kam marrë cigaren dhe sa kam kthyer kurizin, ky më shau, duke më thënë "të q... racën". unë nuk ja kam vënë veshin dhe kam dalë përjashta dhe jam ulur tek tavolina ime. Më pas ai ka vazhduar të shante në drejtimin tim, të njëjtën sharje që më tha më sipër. ndërkohë ka ofenduar edhe Klodin, duke e thirrur me emrin e të jëmës, por edhe ai nuk ja vuri veshin. Duke qenë kjo situatë, që ai vazhdonte nga brenda të shante, unë kam hyrë brenda dhe i kam thënë "ore çfarë ke që shan" por ai ka vazhduar sërish të shajë dhe unë i kam thënë "po hajde pak jashtë të flasim". Ai më tha "po hajde se çfarë do më bësh, do më hash k...in" dhe kemi dalë jashtë. Unë kam dashur t'i fus një shpullë ta qetësoja, por sa i jam afruar kam ngritur dorën, ai është rrëzuar në tokë dhe nuk u ngrit më. Mua nuk më është besuar hiç dhe pasi jam frikësuar nga situatë, jam larguar. Dua të them se unë kisha gjithë ditën që konsumoja alkool dhe me sa pashë edhe ai ishte i dehur. Rrugës për në fshatin Buçimas kam ndaluar makinën time në krah të rrugës dhe kam fjetur, pasi isha i dehur, kur më ka dalë gjumi. mora në telefon avokatin. duke i thënë se çfarë kishte ndodhur, pasi kisha merak dhe ai më tha që personi i dëmtuar kishte ndërruar jetë. Në këtë moment i kam thënë avokatit "eja më merr dhe më shoqëro për në komisariat sepse dua të jap deklaratimet time". Dua të theksoj se nuk kam patur konflikte me personin e dëmtuar, as nuk kam patur njohje me të. nuk kam patur qëllim për të sjellë këtë pasojë, por edhe nuk kam patur qëllim që t'i shkaktoj asnjë lloj dëmtimi. kam dashur vetëm t'i tërheq vëmendjen, por ai ishte në gjendje aq të dehur sa me zor e mbanin këmbët".

I pyetur se kush ka qenë i pranishëm në kohën kur ndodhi debati, ai është shprehur: "Unë mbaj mend vetëm këta të dy që kisha në tavolinë, personin që u dëmtua dhe pronarin e lokalit".

I pyetur nëse gjatë kohës që dolën jashtë së bashku me shtetasin Eglantin Proga, a është afruar dikush tjetër pranë tyre, ai është shprehur: "Jo, kur kemi dalë nga lokali nuk ka ardhur njeri tjetër. unë nuk e mora në cep. atje isha në rrugë".

I pyetur se si u rrëzua papritur shtetasi Eglantin Proga, ai ka deklaruar: "Jo, nuk e mbaj mend, unë isha shumë i dehur dhe nuk e di si u rrëzua".

I pyetur nëse ai apo dikush tjetër e kishin gjuajtur me send, grusht apo shkelma shtetasin Eglantin Proga, ai është shprehur: "Jo".

I pyetur nëse kishte mjete të parkuara apo në lëvizje gjatë kohës që Eglantin Proga është rrëzuar, ai është shprehur: "Nuk mbaj mend gjë".

Gjithashtu shtetasi Denis Meçe ka shtuar: "Ndjehem i penduar edhe pse kam qenë në gjendje të dehur, i kërkoj falje familjes dhe kërkoj që të zbardhet e vërteta, pasi siç e thashë jo vetëm që nuk kam patur qëllim për ta vrarë, por as për t'i shkaktuar ndonjë lloj dëmtimi. Aktualisht jam i rënduar psikologjikisht dhe nuk mund të jap të dhëna të tjera, për shkak të gjendjes psikologjike, pasi jam edhe i shokuar".

Në cilësinë e provës materiale është marrë një DVR i markës "Hikvision" i montuar tek Supermarket BigMarket tek rrethroturllimi, vendi i quajtur Agjensia Rr."Gani Butka", Pogradec, e cila është dërguar për ekspertim.

Në cilësinë e provës materiale në ambjentet e morgut të Spitalit Pogradec janë marrë: një bluzë pambuku me ngjyrë të bardhë me lule të vogla në formë gjethesh me ngjyra gri në bëzhë, me jakë në pjesën e përparme me dy kopsa. Kjo bluzë në pjesën e supit të majtë ka pesë pikëzime me ngjyrë të kuqëremtë si ato të gjakut (hequr kufomës); Një eprovatë sterile me një sasi gjaku marrë kufomës së shtetasit Eglantin Proga model krahasimi.

Gjithashtu, në cilësinë e provës materiale është marrë një aparat celular i markës iPhone 15, me ngjyrë gri të errët, me kasë material plastik i tejudkshëm, me sim kart në brendësi të tij.



Nga poseduesi, shtetasi Leonidha Guçe nuk është dhënë pin i sim kartës dhe as password i telefonit.

Gjithashtu në cilësinë e provës materiale është marrë një aparat celular i markës iPhone 13, me trup ngjyrë bojëqielli, me kasë materil plastik transparent me nr-IMEI-358110345561208 dhe IMEI 2358110345583137, me kod hapje tastjere 198411. Ka në brendësi sim kart të kompanisë Vodafone nr. 0693412480. Ky aparat i përket shtetasit Volant Shkulaku.

Nga përgjimi ambjental i kryer shtetasve Leonidha Guçe dhe Arian Manellari, duket se ata i tregojnë njeri-tjetrit që kanë deklaruar se nuk kishin lidhje me ngjarjen dhe nuk kishin parë gjë dhe pretendonin se meqënëse ishin shoqëruar ata, duhet të ishte shoqëruar edhe "Voli", i cili kishte parë ngjarjen. Gjithashtu, nga bisedat e tyre rezulton se ata pyesin njëri-tjetrin se si kishte mundësi që viktima vdiq nga një grusht i Denisit, fakt që tregon që ata e kishin parë ngjarjen.

Për sa më sipër, nga ana e policisë gjyqësore është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit Denis Meçe për kryerjen e veprës penale "Vrasja me dashje", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, si dhe e shtetasve Volant Shkulaku, Arian Manellari dhe Leonidha Guçe, për kryerjen e veprës penale "Moskallëzimi i krimit", parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, pasi i janë referuar materialet hetimore, në date 10.08.2024, është regjistruar procedimi penal nr.980, për kryerjen e veprës penale "Vrasja nga pakujdesia", parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Denis Meçe, si dhe për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", parashikuar nga neni 300 i K.Penal. Në ngarkim të shtetasve Leonidha Guçe, Arian Manellari dhe Voltan Shkulaku.

Faktet e mësipërme mbështeten në provat dhe aktet e tjera shkresore të paraqitura nga Prokuroria dhe të shqyrtuara në seancë gjyqësore:

- Urdhër për regjistrimin e procedimit penal; Informacion për referimin e veprës penale;
- Procesverbal për këqyrjen e vendit të ngjarjes;
- Procesverbal për këqyrjen e kufomës;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Ardjan Bego;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Andi Shkullaku;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Roland Bezatliu;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Voltan Shkulaku;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Arian Manellari;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Leonidha Guçe;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Denis Meçe;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Voltan Shkulaku;



- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Arian Manellari;
- Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Leonidha Guçe;
- Procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale (DVR);
- Procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale (aparate celulare iPhone 15, në posedim të shtetasit Leonidha Guçe);
- Procesverbal për sekuestrimin e sendeve iPhone 13, në posedim të shtetasit Voltan Shkulaku;
- Procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale (sendet e viktimës);
- Procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Denis Meçe;
- Procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Voltan Shkulaku;
- Procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Arian Manellari;
- Procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit Leonidha Guçe;
- Procesverbal për kontrollin personal të shtetasit Denis Meçe;
- Procesverbal për kontrollin personal të shtetasit Voltan Shkulaku;
- Procesverbal për kontrollin personal të shtetasit Arian Manellari;
- Procesverbal për kontrollin personal të shtetasit Leonidha Guçe;
- Të dhëna nga sistemi TIMS për shtetasit nën hetim;
- Certifikata vertetimi të gjendjes gjyqësore;
- Prontime nga sistemi ADAMS për shtetasin Denis Meçe.

Avokati Eduart Muçi si mbrojtës i zgjedhur për shtetasin e arrestuar Denis Meçe deklaroi se ky shtetas nuk ka pasur për qëllim t'i fshihet drejtësisë, largimi i tij menjëherë pas ngjarjes ka qenë i pavullnetshëm dhe në kushtet kur ka qenë i dehur. Ai ka fjetur në automjet derisa është përmendur, ka telefonuar atë si avokat, dhe pasi i është shpjeguar se çfarë kishte ndodhur, vetë i ka kërkuar për ta shoqëruar për në Komisariatin e Policisë. Vullneti i tij ka qenë për të dhënë shpjegime në lidhje me sa ka ndodhur, pasi ai nuk ka pasur për qëllim të kryejë vrasjen e një shtetasi, dhe as të largohet, pavarësisht se pasoja është e rëndë dhe kemi të bëjmë me humbjen e një jete.

Sipas mbrojtjes, arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi duhet të cilësohet si i ligjshëm, por kërkohet që ndaj këtij shtetasi të caktohet një tjetër masë sigurimi, e ndryshme nga arresti në burg, mbajtur parasysh marzhin e dënimit që parashikon dispozita, rrethanat e kryerjes së veprës penale, mënyrën si ka ndodhur ngjarja, qëndrimin e personit nën hetim, faktin që nuk ka qenë i dënuar më parë, faktin që nuk ekziston mundësia për t'u larguar apo për t'iu fshehur drejtësisë, faktin që nuk ka mundësinë e dëmtimit apo prishjes së provave.

Kërkohet nga gjykata që të caktohet si masë sigurimi "arrestin në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ose "Garancia pasurore" në shumën 1.000.000 lekë, e cila është një vlerë e konsiderueshme dhe i garanton gjykatës që nëse ky person i fshihet drejtësisë dëmi ekonomik do të jetë tepër i madh.

Vetë shtetasi nën hetim Denis Meçe deklaroi se është dakord me sa parashitroi avokati. Ai kërkon ndjesë dhe është tepër i keqardhur për sa ka ndodhur, pas ai nuk ka pasur për qëllim ta dëmtojë dhe aq më tepër ta vrasë të ndjerin.

Avokati Budion Hoxha si mbrojtës i zgjedhur për shtetasin e arrestuar Voltan Shkulaku deklaroi se me provat e paraqitura nga ana e prokurorisë, nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm për veprën penale të moskallzimit të krimit. Ky shtetas është pronar i lokalit dhe duke u marrë me punë brenda në lokal, nuk e ka parë ngjarjen, kur e ka parë ka dhënë ndihmën e parë. Në këto kushte, kur nuk ka dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova për këtë veprë



penale, arrestimi në flagrancë duhet të cilësohet si jo i ligjshëm, po ashtu nuk ka vend që të caktohet masë sigurimi për këtë shtetas.

Vetë shtetasi nën hetim Voltan Shkulaku deklaroi se është dakord me sa parashtroi avokati.

Avokati Esmerald Xhafa si mbrojtës i zgjedhur për shtetasit e arrestuar Arian Manellari dhe Leonidha Guçe, deklaroi se me provat e paraqitura nga ana e prokurorisë, nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se nga ana e këtyre dy shtetasve të jetë konsumuar vepra penale e moskallzimit të krimit. Gjithsesi, duke qenë se jemi në fillim të hetimit, i përket atij të zbardhë ngjarjen dhe faktin nëse jemi apo jo para kësaj veprë penale. Në këto kushte, mbrojtja shprehet dakord me vlefësimin e arrestimit në flagrancë, si dhe me caktimin e masës së sigurimit të kërkuar nga prokuroria për këta shtetas, masë e cila për ligj edhe nevojat e sigurimit.

Vetë shtetasi nën hetim Arian Manellari deklaroi se është dakord me sa parashtroi avokati.

Vetë shtetasi nën hetim Leonidha Guçe deklaroi se është dakord me sa parashtroi avokati.

Në lidhje me shtetasin Denis Meçe, Gjykata, mbështetur në kërkesat e nenit 251 të K.Pr.Penale, çmon se arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi është i ligjshëm, dhe kjo pasi:

Së pari: I arrestuari është dyshuar për kryerjen e një veprë penale, për të cilën ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët se dy vjet në maksimum. Në rastin konkret, për veprën penale për të cilën është dyshuar i arrestuari të parashikuar nga neni 86 i K.Penal, ligji parashikon si sanksion dënimin me burgim nga 10 deri në 20 vjet.

Së dyti: I arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi neni 252 i K.Pr.Penale përcakton: "Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale". Sipas kësaj dispozite, që subjekti i dyshuar të jetë në gjendjen e flagrancës, duhet që ai së pari jetë kapur në kryerje e sipër të veprës penale, ose së dyti menjëherë pas kryerjes së veprës të ndiqet nga policia gjyqësore apo nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, dhe së treti të jetë kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Referuar akteve procedurale të hartuara gjatë veprimeve të para hetimore, rezulton se i arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi ai është kapur nga policia menjëherë pas kryerjes së veprës penale dhe identifikimit të tij si person i përfshirë në ngjarje.

Nga ana tjetër, duke mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 e 229 të K.Pr.Penale, gjykata vlerëson se ka vend që të pranohet kërkesa për caktim mase sigurimi ndaj shtetasit Denis Meçe, dhe kjo pasi:

Së pari: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provat e mësipërme, (neni 228/1 i K.Pr.Penale) që i dyshuari të ketë kryer veprën penale që i atribuohet, për të cilën prokuroria ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të tij, parashikuar nga neni 85 i K.Penal.

Së dyti: Nuk ka shkaqe të shuarjes së veprës penale apo shkaqe padënueshmërie për të dyshuarin (neni 228/2 i K.Pr.Penale).

Së treti: Ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'iu fshehur hetimeve, (neni 228/2/b i K.Pr.Penale), kjo duke marrë shkas edhe nga masa e dënimit që parashikon dispozita përkatëse. Po ashtu ekziston rreziku që i dyshuari të kryejë vepra të tjera penale.

Së katërti: Nevoja për caktimin e një mase sigurimi, në mënyrë që i dyshuari të jetë në dispozicion të organit të akuzës, rezulton edhe nga rrethanat dhe lloji i veprës penale për të cilën ky person dyshohet, vepër për të cilën ligji parashikon dënim me burgim (neni 85 i K.Penal parashikon dënim gjer në 5 vjet burgim).



Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal për shtetasin Denis Meçe, gjykata vlerëson se referuar kritereve të përcaktuara në nenin 229 të K.Pr.Penale, si dhe duke mbajtur parasysh shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën dyshohet ky shtetas por edhe rrezikshmërinë e autorit, rrethanat dhe mënyra e konsumimit të veprës për të cilën ai dyshohet, mbi të gjitha pasoja e rëndë që ka ardhur ku ka humbur jetën një person, masa e sigurimit "arrest në burg" e kërkuar nga Prokuroria është e përshtatshme.

Sipas gjykatës, shkalla e nevojave të sigurimit në rastin konkret ka të bëjë me ekzistencën e mundësisë të personit të dyshuar për t'ju shmangur procedimit penal duke qenë se akuzohet për një krim që parashikon dënim me burgim, por edhe me faktin se i hetuari mund të kryejë veprën penale po kaq të rëndë apo më të rëndë, duke mbajtur parasysh këtu faktin që ai paraqitet person me precedent të mëparshëm penal, por edhe me rrezikun për të ndikuar në marrjen apo vërtetësinë e provave.

Po ashtu, Gjykata sjell në vëmendje faktin se referimi nga policia është bërë për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i K.Penal, pavarësisht se i përket Prokurorisë të çmojë se për çfarë vepre duhet të regjistrojë procedimin penal, referuar provave që disponon apo indicieve të bazuara në prova në lidhje me veprën penale. Aktualisht jemi në momentet e para të hetimit dhe Prokuroria disponon vetëm të dhënat e grumbulluara deri në këto momente, ndërkohë që janë duke u kryer veprime të tjera hetimore si marrja e konkluzioneve të akteve të ekspertimit mjeko-ligjor për viktimën, këqyrja me ekspert e kamerave që janë marrë nga objekte afër vendit të ngjarjes, etj, prej të cilave në vijim pritet të zbardhet plotësisht dinamika e ngjarjes dhe për rrjedhim mund të arrihet edhe në konkluzione të ndryshme lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, të ndryshëm apo më të rëndë nga ajo për të cilën është regjistruar fillimisht procedimi penal për këtë shtetas.

Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Gjykata çmon se, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja për një masë më të lehtë, masa e sigurimit personal "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, e aplikuar ndaj shtetasit Denis Meçe, i përgjigjet të gjitha kushteve dhe kritereve ligjore dhe është në përputhje me rëndësinë e faktit dhe shkallën e nevojave të sigurimit, dhe se asnjë masë tjetër sigurimi personal nuk mund të jetë e përshtatshme në rastin konkret.

Në lidhje me shtetasin Voltan Shkulaku, Gjykata, mbështetur në kërkesat e nenit 251 të K.Pr.Penale, çmon se arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi është i ligjshëm, dhe kjo pasi:

Së pari: I arrestuari është dyshuar për kryerjen e një vepre penale, për të cilën ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët se dy vjet në maksimum. Në rastin konkret, për veprën penale për të cilën është dyshuar i arrestuari të parashikuar nga neni 300 i K.Penal, ligji parashikon si sanksion dënimin me burgim deri në 3 vjet.

Së dyti: I arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi neni 252 i K.Pr.Penale përcakton: "Është në gjendje flagrancë ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale". Sipas kësaj dispozite, që subjekti i dyshuar të jetë në gjendjen e flagrancës, duhet që ai së pari jetë kapur në kryerje e sipër të veprës penale, ose së dyti menjëherë pas kryerjes së veprës të ndiqet nga policia gjyqësore apo nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, dhe së treti të jetë kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Referuar akteve procedurale të hartuara gjatë veprimeve të para hetimore, rezulton se i arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi ai është kapur nga policia menjëherë pas kryerjes së veprës penale, ku duket se ai ka pasur dijeni për sa ka ndodhur dhe nuk ka kallëzuar kur është pyetur në lidhje me ngjarjen.



Nga ana tjetër, duke mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 e 229 të K.Pr.Penale, gjykata vlerëson se ka vend që të pranohet kërkesa për caktim mase sigurimi ndaj shtetasit Voltan Shkulaku, dhe kjo pasi:

Së pari: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provat e mësipërme, (neni 228/1 i K.Pr.Penale) që i dyshuari të ketë kryer veprën penale që i atribuohet, parashikuar nga neni 300 i K.Penal. Edhe pse për sqarimin e çdo pretendimi të të dyshuarit do të duhet të kryhen veprime të mëtejshme hetimore, këto i përkasin vërtetimit të akuzës dhe fazës së përfundimit të hetimeve ku dhe prokuroria konkludon lidhur me marrjen të pandehur dhe kualifikimin juridik të faktit penal. Por nga ana tjetër, me provat e grumbulluara deri më tani, krijohet dyshimi i arsyeshëm se nga ana e tij mund të jetë konsumuar kjo veprë për të cilën është regjistruar ky procedim penal.

Së dyti: Nuk ka shkaqe të shuarjes së veprës penale apo shkaqe padënueshmërie për të dyshuarin (neni 228/2 i K.Pr.Penale).

Së treti: Ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'iu fshehur hetimeve, (neni 228/2/b i K.Pr.Penale), kjo duke marrë shkas edhe nga masa e dënimit që parashikon dispozita përkatëse.

Së katërti: Nevoja për caktimin e një mase sigurimi, në mënyrë që i dyshuari të jetë në dispozicion të organit të akuzës, rezulton edhe nga rrethanat dhe lloji i veprës penale për të cilën ky person dyshohet, veprë për të cilën ligji parashikon dënim me burgim (neni 300 i K.Penal parashikon dënim gjer në 3 vjet burgim).

Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal për shtetasin Voltan Shkulaku, gjykata vlerëson se referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 229 të K.Pr.Penale, si dhe duke mbajtur parasysh shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën dyshohet ky shtetas por edhe rrezikshmërinë e autorit, rrethanat në të cilat është konsumuar vepra për të cilën ai dyshohet, si dhe duke iu referuar nenit 244 pika 3 të K.Pr.Penale në kuptimin që është organi i Prokurorisë që vlerëson në çdo rast nevojat e sigurimit referuar gjendjes së procedimit penal dhe nevojave të hetimit, Gjikata çmon që ndaj shtetasit Voltan Shkulaku të caktohet si masë sigurimi ajo e "Detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, masë e cila u kërkuar edhe nga ana e Prokurorisë.

Në lidhje me shtetasin Arian Manellari, Gjikata, mbështetur në kërkesat e nenit 251 të K.Pr.Penale, çmon se arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi është i ligjshëm, dhe kjo pasi:

Së pari: I arrestuari është dyshuar për kryerjen e një vepre penale, për të cilën ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët se dy vjet në maksimum. Në rastin konkret, për veprën penale për të cilën është dyshuar i arrestuari të parashikuar nga neni 300 i K.Penal, ligji parashikon si sanksion dënimin me burgim deri në 3 vjet.

Së dyti: I arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi neni 252 i K.Pr.Penale përcakton: "Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale". Sipas kësaj dispozite, që subjekti i dyshuar të jetë në gjendjen e flagrancës, duhet që ai së pari jetë kapur në kryerje e sipër të veprës penale, ose së dyti menjëherë pas kryerjes së veprës të ndiqet nga policia gjyqësore apo nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, dhe së treti të jetë kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Referuar akteve procedurale të hartuara gjatë veprimeve të para hetimore, rezulton se i arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi ai është kapur nga policia menjëherë pas



*e masave të sigurimit  
se ka vend që të*

kryerjes së veprës penale, ku duket se ai ka pasur dijeni për sa ka ndodhur dhe nuk ka kallëzuar kur është pyetur në lidhje me ngjarjen.

Nga ana tjetër, duke mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 e 229 të K.Pr.Penale, gjykata vlerëson se ka vend që të pranohet kërkesa për caktim mase sigurimi ndaj shtetasit Arian Manellari, dhe kjo pasi:

Së pari: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provat e mësipërme, (neni 228/1 i K.Pr.Penale) që i dyshuari të ketë kryer veprën penale që i atribuohet, parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Së dyti: Nuk ka shkaqe të shuarjes së veprës penale apo shkaqe padënueshmërie për të dyshuarin (neni 228/2 i K.Pr.Penale).

Së treti: Ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'iu fshehur hetimeve, (neni 228/2/b i K.Pr.Penale), kjo duke marrë shkas edhe nga masa e dënimit që parashikon dispozita përkatëse.

Së katërti: Nevoja për caktimin e një mase sigurimi, në mënyrë që i dyshuari të jetë në dispozicion të organit të akuzës, rezulton edhe nga rrethanat dhe lloji i veprës penale për të cilën ky person dyshohet, veprë për të cilën ligji parashikon dënim me burgim (neni 300 i K.Penal parashikon dënim gjer në 3 vjet burgim).

Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal për shtetasin Arian Manellari, gjykata vlerëson se referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 229 të K.Pr.Penale, si dhe duke mbajtur parasysh shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën dyshohet ky shtetas por edhe rrezikshmërinë e autorit, rrethanat në të cilat është konsumuar vepra për të cilën ai dyshohet, si dhe duke iu referuar nenit 244 pika 3 të K.Pr.Penale në kuptimin që është organi i Prokurorisë që vlerëson në çdo rast nevojat e sigurimit referuar gjendjes së procedimit penal dhe nevojave të hetimit, Gjukata çmon që ndaj shtetasit Arian Manellari të caktohet si masë sigurimi ajo e "Detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, masë e cila u kërkua edhe nga ana e Prokurorisë.

Në lidhje me shtetasin Leonidha Guçe, Gjukata, mbështetur në kërkesat e nenit 251 të K.Pr.Penale, çmon se arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi është i ligjshëm, dhe kjo pasi:

Së pari: I arrestuari është dyshuar për kryerjen e një vepre penale, për të cilën ligji cakton dënim me burgim jo më të ulët se dy vjet në maksimum. Në rastin konkret, për veprën penale për të cilën është dyshuar i arrestuari të parashikuar nga neni 300 i K.Penal, ligji parashikon si sanksion dënimin me burgim deri në 3 vjet.

Së dyti: I arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi neni 252 i K.Pr.Penale përcakton: "Është në gjendje flagrance ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale". Sipas kësaj dispozite, që subjekti i dyshuar të jetë në gjendjen e flagrancës, duhet që ai së pari jetë kapur në kryerje e sipër të veprës penale, ose së dyti menjëherë pas kryerjes së veprës të ndiqet nga policia gjyqësore apo nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë, dhe së treti të jetë kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Referuar akteve procedurale të hartuara gjatë veprimeve të para hetimore, rezulton se i arrestuari ka qenë në gjendjen e flagrancës, pasi ai është kapur nga policia menjëherë pas kryerjes së veprës penale, ku duket se ai ka pasur dijeni për sa ka ndodhur dhe nuk ka kallëzuar kur është pyetur në lidhje me ngjarjen.



Nga ana tjetër, duke mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga neni 228 e 229 të K.Pr.Penale, gjykata vlerëson se ka vend që të pranohet kërkesa për caktim mase sigurimi ndaj shtetasit Leonidha Guçe, dhe kjo pasi:

Së pari: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provat e mësipërme, (neni 228/1 i K.Pr.Penale) që i dyshuari të ketë kryer veprën penale që i atribuohet, parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Së dyti: Nuk ka shkaqe të shuarjes së veprës penale apo shkaqe padënueshmërie për të dyshuarin (neni 228/2 i K.Pr.Penale).

Së treti: Ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'iu fshehur hetimeve, (neni 228/2/b i K.Pr.Penale), kjo duke marrë shkas edhe nga masa e dënimit që parashikon dispozita përkatëse.

Së katërti: Nevoja për caktimin e një mase sigurimi, në mënyrë që i dyshuari të jetë në dispozicion të organit të akuzës, rezulton edhe nga rrethanat dhe lloji i veprës penale për të cilën ky person dyshohet, veprë për të cilën ligji parashikon dënim me burgim (neni 300 i K.Penal parashikon dënim gjer në 3 vjet burgim).

Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal për shtetasin Leonidha Guçe, gjykata vlerëson se referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 229 të K.Pr.Penale, si dhe duke mbajtur parasysh shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën dyshohet ky shtetas por edhe rrezikshmërinë e autorit, rrethanat në të cilat është konsumuar vepra për të cilën ai dyshohet, si dhe duke iu referuar nenit 244 pika 3 të K.Pr.Penale në kuptimin që është organi i Prokurorisë që vlerëson në çdo rast nevojat e sigurimit referuar gjendjes së procedimit penal dhe nevojave të hetimit, Gjykata çmon që ndaj shtetasit Leonidha Guçe të caktohet si masë sigurimi ajo e "Detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, masë e cila u kërkuar edhe nga ana e Prokurorisë.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 259 e 245 të K.Pr.Penale

## VENDOSI

1. Të vleftësojë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit **Denis Meçe**, të kryer në datë 11.08.2024, ora 05.00, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja nga pakujdesia", parashikuar nga neni 85 i K.Penal.

1.1. Të caktojë ndaj shtetasit Denis Meçe si masë sigurimi atë të "Arrestit në burg", parashikuar nga Neni 238 i K.Pr.Penale.

1.2. Urdhërohet izolimi i shtetasit Denis Meçe në një institucion paraburgimi për të qenë në dispozicion të autoritetit procedues.

2. Të vleftësojë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit **Voltan Shkulaku**, të kryer në datë 11.08.2024, ora 02.00, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Moskallzimi i krimit", parashikuar nga neni 300 i K.Penal.



sigurimi  
te te

2.1. Të caktojë ndaj shtetasit Voltan Shkulaku si masë sigurimi atë të “Detyrimit për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga Neni 234 i K.Pr.Penale, duke u urdhëruar ky shtetas që të paraqitet tek oficeri i policisë gjyqësore Redi Kamenica në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10.00.

2.2. Urdhërohet lirimi i shtetasit Voltan Shkulaku nga dhomat e izolimit të Komisarariatit të Policisë Korçë, në rast se nuk mbahet për ndonjë shkak apo arsye tjetër.

3. Të vlefësojë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit **Arian Manellari**, të kryer në datë 11.08.2024, ora 01.00, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Moskallzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

3.1. Të caktojë ndaj shtetasit Arian Manellari si masë sigurimi atë të “Detyrimit për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga Neni 234 i K.Pr.Penale, duke u urdhëruar ky shtetas që të paraqitet tek oficeri i policisë gjyqësore Redi Kamenica në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10.00.

3.2. Urdhërohet lirimi i shtetasit Arian Manellari nga dhomat e izolimit të Komisarariatit të Policisë Korçë, në rast se nuk mbahet për ndonjë shkak apo arsye tjetër.

4. Të vlefësojë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit **Leonidha Guçe**, të kryer në datë 11.08.2024, ora 01.00, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Moskallzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

4.1. Të caktojë ndaj shtetasit Leonidha Guçe si masë sigurimi atë të “Detyrimit për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga Neni 234 i K.Pr.Penale, duke u urdhëruar ky shtetas që të paraqitet tek oficeri i policisë gjyqësore Redi Kamenica në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10.00.

4.2. Urdhërohet lirimi i shtetasit Leonidha Guçe nga dhomat e izolimit të Komisarariatit të Policisë Korçë, në rast se nuk mbahet për ndonjë shkak apo arsye tjetër.

5. Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, në datë 13.08.2024 ora 12:33

SEKRETARE  
ELIDA HYMETI

GJYQTARE  
LULJETA KOLE

